



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 23.07.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.07.2026 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me perde për shkolla", Nr. i prokurimit- 632-26-4052-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-026-121, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., e dt.15.07.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me perde për shkolla", Nr. i prokurimit- 632-26-4052-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-026-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 10.07.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 10.07.2026;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., me dt.15.07.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me perde për shkolla", Nr. i prokurimit- 632-26-4052-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-026-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 23.07.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj lidhur me ISO-t, është i pabazuar, sepse ISO -t, nuk janë kërkuar te kërkesat për pjesëmarrje por te paramasa dhe parallogaria;

Pretendimi juaj lidhur realizimin e kontratave nuk qëndron, sepse GOE i rekomanduar për nënshkrimin e kontratës ka prezantuar referenca te kontratave për furnizim;

Pretendimi juaj lidhur me vërtetimet e gjykatës dhe ATK-së, nuk qëndron sepse në dosjen e tenderit ceket se këto duhet ti dorëzohet Operatori ekonomik fitues bazuar në Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik:

“Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës”

Pretendimi juaj lidhur me ISO-t, për OE Zebra Store dhe Gama Consulting është i pabazuar, sepse ISO –t, nuk janë kërkuar të kërkesat për pjesëmarrje por të paramasa dhe parallogaria;

Pretendimi juaj lidhur me deklaratën për specifikimet teknike të OE Gama Consulting është i bazuar, por kjo nuk e ndërrohet vendimin e Autoritetit kontraktues sepse i njëjti është vlerësuar si i pasuksesshëm nga Autoriteti kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

